

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" EQUESTRIAN SKILLS" SHPK

Sot ne daten 30.10.2024 ,une ortaku themelues :

VITTORIO D'ALO', atësia Gianni, amësia Maria Pia, shtetas Italian, lindur në MILANO dhe banues në Durres, me adresë Ramazan Jella 00690691; Nd.14 2025, Durres lindur më 26/05/1967, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Karte Identiteti Italiane nr. CA30346FQ, si edhe i pajisur me Leje qendrimi nr.280317, dhe nr. personal shqiptar G73526001L.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " EQUESTRIAN SKILLS " SHPK.

NENI 1.

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet " EQUESTRIAN SKILLS" SHPK dhe eshte person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne: **Bisht Kamez, Durres, ZK 1198, nr.pasurie 12/240.**

Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Udhetime dhe Ture profesionale me kuaj, trajnime kuajsh, kalorsish. Aktivitete.

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise " EQUESTRIAN SKILLS " SHPK eshte 1000 (njemije) leke.

Ky kapital perbehet nga 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% ,nga ortaku i vetem i saj, **zoti VITTORIO D'ALO'.**

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE

-Asambleja e pergjithshme.

-Administratoret.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:



- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete zoti **VITTORIO D'ALO'**, atësia Gianni, amësia Maria Pia, shtetas Italian, lindur në MILANO dhe banues në Durres, me adresë Ramazan Jella 00690691; Nd.14 2025, Durres lindur më 26/05/1967, gjendja civile "I martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Karte Identiteti Italiane nr. CA30346FQ, si edhe i pajisur me Leje qendrimi nr.280317, dhe nr. personal shqiptar G73526001L, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripërteritje.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja, me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

NENI 8


Prishja e shoqerise.

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "QKR",
- d) me vendim te gjykates,
- dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

VITTORIO D'ALO'



NENI 9
Likuidimi i shoqërisë.

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet

ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës

Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

NENI 10
Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

NENI 11
MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast të kundërt, ortaket themelues do të drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhje.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË "EQUESTRIAN SKILLS" SHPK

VITTORIO D'ALO'

Vittorio D'ALO'
